

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

Periudha raportuese tetor – dhjetor 2015

Hyrje

Aktualisht ndërhyrja për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për fëmijët në situatë rruge, po zbatohet që prej 2015, në 4 bashki në vend Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier. Bazuar në këtë plan janë planifikuar takime me kryetarët e bashkive Shkodër, Korçë dhe Vlorë për zgjerimin e tij në këto bashki. Në këtë kuadër në muajin nëntor u organizua në bashkinë Shkodër me pjesëmarrjen e Ministrit të MMSR dhe Kryetares së Bashkisë Shkodër takimi institucional për implementimin e Planit të Veprimit në bashkinë Shkodër

Ky është raporti i tretë periodik hartuar nga Agjencia, në bazë të raportimit periodik (tetor – dhjetor) nga katër bashkitë e përfshira. (NJMF-të dhe koordinatorët e skuadrave të terrenit)

Deri tani janë ndarë me aktorët e përfshirë në zbatim të planit një raport vjetor për periudhën qershor 2014 – qershor 2015 dhe dy raporte 3 mujore periodike mars-qershor 2015 dhe korrik – shtator 2015.

Ecuria e punës

- **Puna e skuadrave të terrenit**

Në bashkitë e përfshira funksionojnë skuadrat e terrenit të cilat identifikojnë rastet e fëmijëve në situatë rruge sipas kalendarit të hartuar dhe ndarë me aktorët.

Në bashkinë Durrës gjatë këtyre 3 muajve, ka funksionuar një skuadër terreni që ka kryer 6 vizita në terren. Skuadra është e përbërë nga përfaqësues të institucioneve nga NJMF, Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashki.

Këtë periudhë është ulur numri i vizitave në terren për arsye se numri i rasteve është ulur. Orët me fluks më të madh janë orët e ardhjes së trageteve, si gjatë ditës ashtu edhe gjatë pasdites e mbrëmjes. Puna është përqëndruar në menaxhimin e rasteve të identifikuar më parë. Për periudhën tre mujore janë identifikuar 13 raste të reja.

Në bashkinë Elbasan aktualisht janë aktive 3 skuadra të cilat përveç identifikimit bëjnë monitorimin e rasteve që janë në menaxhim. Janë kryer *42 vizita në terren por duke parë situatën u pa e arsyeshme të bëhen dalje në terren në orët e pasdites. Njëkëtë orar janë realizuar 3 orëçdo javë dhe gjithësej 36 vizita në terren.* Nuk ka pasur raste të reja të identifikuara, por vazhdon puna për ndjekjen e rasteve. Monitorimi vazhdon për 19 rastet e identifikuara më parë. Gjatë kësaj periudhe 3 mujore, Skuadra e terrenit ka identifikuar një rast ku fëmija është dërguar në shërbimet e emergjencës dhe pas shërbimeve të ofruara është rikthyer në shtëpi. Gjithashtu ka një rast përsëritës ku fëmija është identifikuar përsëri pas një periudhe të gjatë që nuk ishte parë në takim.

Raportohet që falë punës sistematike në terren numri i fëmijëve që lypin në qytetin e Elbasanit është zvogëluar ndjeshëm.

Në bashkinë Fier, kanë vepruar 2 skuadra aktive në terren që kanë kryer *25 vizita në terren* të përbëra nga NJMF-të dhe punonjës nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale. Janë identifikuar *2 raste të reja*, kurse raste e tjera janë të identifikuar më parë. Më së shumti fëmijët janë identifikuar në orët e paradites duke lypur në rrugë. Gjatë festave të fundvitit u konstatua rritje e numrit të fëmijëve që lypin në rrugët e qytetit. Për këtë arsye u intensifikuan vizitat në terren gjatë festave duke realizuar 12 orë në terren gjatëditës. Në tërësinë e shërbimeve të ofruara kemi këto rezultate: janë ofruar shërbime për 5 fëmijë në orët e pasditeve, për 5 fëmijë janë ofruar në rrugë ushqim, veshje dhe janë shoqëruar në familje, 5 fëmijë janë shoqëruar në shërbimet shëndetësore.

Në bashkinë Tiranë, deri në muajin nëntor kanë vepruar 11 skuadra terreni të përbëra nga NJMF dhe punonjës social të organizatave ARSIS, SHKEJ, Qendra Ditore për Fëmijët në situatë rruge, “Të ndryshëm dhe të barabartë”, si dhe të mbështetura nga Bërthama deri në muajin nëntor. Në muajin dhjetor aktualisht kanë qenë aktive 9 skuadra terreni, kjo sepse Punonjësit e Mbrojtjes së fëmijëve në Njësitë Bashkiake nr 9 dhe nr 10 nuk ka qenë aktive për arsye shëndetësore, por territori është monitoruar nga skuadrat e tjera. Monitorimi i terrenit është mbuluar gjatë orareve paradite (9:00-13:00) dhe pasdite deri në muajin nëntor (17:00-19:00). Në muajt nëntor-dhjetor puna është fokusuar tek monitorimi i rasteve të trajtuara më parë, prandaj në kalendarin e daljeve është parashikuar dalje një herë në javë. Rezultatet e punës së deritanishme ka bërë që të identifikohen vetëm 10 raste të reja. Për periudhën e festave ka pasur shtim të numrit të fëmijëve në situatë rruge në zonën e Laprakës dhe janë identifikuar raste të reja nga rrethet në rrugën e Elbasanit.

Për identifikimin e rasteve ASHMDF bashkë me NJMF nr 4 dhe nr 11, Zyrën e Punës, Policinë e Qarkut Tiranë, Komisariatit nr 4, Komisariatit nr 2 dhe me organizatat ARSIS, SHKEJ dhe FBSH, gjatë muajve tetor – dhjetor ka realizuar 3 vizita në komunitet e targetuara në zonat e Bregut të Lumit dhe Shkozë.

- **Zbatimi i planit të mbrojtjes së fëmijëve dhe menaxhimi i rasteve**

Rastet menaxhohenpërmes punës sëgrupit multidisiplinar në bazë të udhëzimit 4 ministrorNr.10 datë 25.2.2014“Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”

Aktorët e grupeve teknike multidisiplinare janë mbledhur sipas rasteve dhe në mënyrë periodike1 herë në muaj për njëtakim konsultues të përgjithshëm. Raportet nga Durrësi, Fieri dhe Elbasani tregojnë që aktorët më aktivë nëkëto mbledhje kanë qenë policia, shëndetësia, arsimit dhe administratorët socialë.

Në Durrës, në këto takime është diskutuar hap pas hapi për rastet e menaxhuara. Kryesisht puna është fokusuar tek rastet që janë banorë të përhershëm në bashkinë Durrës, për të cilët ka mundësi për shërbime.

Në bashkinë Fier raportohet që bashkëpunimi me familjarët në fillim ka qenëi vështirëpasi lypja ka qenë një proces fitimprurës për familjet dhe i vetmi burim jetese. Të dyja bashkitë raportojnë për pamjaftueshmëri shërbimesh por dhe prej pamundesisë së aksesit në shërbimet ekzistuese.

Në bashkinë Durrës është bashkëpunuar me organizatat “Sot për të ardhmen” dhe Shoqatën “ Në dobi të gruas shqiptare” për menaxhimin e rasteve dhe grupet multidisiplinare. Në bashkinë Fier një ndihmë dhe angazhim të vazhdueshëm ka pasur NJMF me qendren sociale “Murialdo”.

Bashkëpunimi me organizatat dhe qendrat komunitare vazhdon të jetë një ndihmë për punën e NJMF në bashkinë Elbasan. Shumica e fëmijëve të identifikuar marrin shërbime tek fondacioni A2B, qendra “Tjeter Vizion”ku kanë marrë suport me pako ushqimore për 4 muaj. TDH ka dhënë ndihmesë për mikrokredi.

PNJMF të **Bashkisë Tiranë** vazhdojnë punën për mbështetjen e fëmijëve në situatë rruge dhe familjeve tyre. Deri tani janë menaxhuar 64 familje në situatë rruge nëpërmjet mbledhjes së Grupeve Teknike Multidisiplinare. Për familjet e në komunitetin e Shkozës dhe Bregut të Lumit, banorët e komunitetit janë informuar mbi iniciativën e institucioneve shtetërore për të mbështetur fëmijët dhe familjet në situatë rruge. Janë marrë të dhënat e familjeve për t’i referuar Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve për t’i menaxhuar dhe ofruar shërbimet e nevojshme. Janë bërë regjistrimet e banorëve që kanë shprehur dëshirën për tu referuar për punësim duke u pajisur me kartelat e punëkërkesit, të dhënat e tyre janë hedhur në sistem për sistemin e tyre në një punë .

Shërbimet e ofruara janë referim në skemën e ndihmës ekonomike, ofrim i paketave ushqimore,regjistrim në gjendjen civile tëfëmijëve,suport shëndetësor, procedura për kartelat shëndetësore dhe vaksinimin, vendosja e fëmijëve në qendrat rezidenciale ristrukturim banese, frekuentim i qendrave ditore e komunitare.

Në bashkinë Fier ka pasur përpjekje për punësimin e prindërve duke bashkëpunuar me disa biznese për punësimin e tyre. Janë ndërmjetësuar 3 raste për punësim, nga të cilët vetëm një person është punësuar.

Në bashkinë Tiranë, shërbimet e ofruara si regjistrimi i fëmijëve apo transferim i gjendjes civile, paketa ushqimore, aplikimi për ndihmë ekonomike, regjistrim i fëmijëve në shkollë, pagesë qiraje, referim për punësim, medikamente për fëmijët, dhurata dhe veshje për fëmijët, etj janë shërbime që janë mbështetur gjithashtu nga OJF partnere. Një familje është sistemuar në Qendrën Tranzitore të Emergjencave.

Puna e ekipit tëposaçëm për ndërmjetësimin **për punësim të familjarëve dhe të rinjve**, të fëmijëve në situatë rruge ka rezultuar e suksesshme në Tiranë, pavarësisht sfidave. 32 rasteve u është mundur apo nxitjen/ ngritjen e një biznesi social. Jna ë ofruar kurse dhe pajisje në ndihmë të zhvillimit të biznesit. 45 raste janë të punësuar në sektorin privat kryesisht pranë kompanive të pastrimit dhe mirëmbajtjes, fasoneri, call center, oficina mekanike, pastičeri etj. Por ka pasur dhe raste refuzimi (31 raste) ose të braktisjes së punës së ofruar (35 raste) kanë refuzuar punën e ofruar.

- **Frekuentimi i shkollës për fëmijë në situatë rruge**

ASHMDF ka kërkuar nga NJMF-të në vend të monitorojnë regjistrimin dhe frekuentimin e shkollës për fëmijët në situatë rruge të referuar për regjistrim në listat e shtatorit. Listat e përditësuar nga NJMF janë dërguar MAS dhe DAR në muajin nëntor për ndjekje. Në përgjigje janë raportuar 6 raste të reja të regjistruar që ndjekin shkollën (6 raste).

Në tre muajt e fundit, nga NJMF-të e bashkisë Tiranë raportohet që janë regjistruar dhe ndjekin shkollën 21 fëmijë të tjerë duke e çuar në 63 numrin e përgjithshëm për Tiranën, të fëmijëve në situatë rruge të regjistruar dhe ndjekin shkollën.

Deri tani në gjithë vendin raportohen që ndjekin shkollën 139 fëmijë në situatë rruge, nga këta 91 fëmijë nga bashkitë e përfshira.

- **Bashkëpunimi me policinë**

Në bazë të raportimeve konstatohet që në bashkitë e përfshira ka funksionuar bashkëpunimi me policinë e shtetit. Edhe pse në këtë periudhë nuk raportohet për raste të referuara në polici për ndjekje penale, bashkëpunimi ka qenë në rastet kur është kërkuar nga skuadrat e terrenit dhe policia është treguar e gatshme dhe bashkëpunuese. Por ka dhe raste kur policia nuk është përgjigjur, si në rastin e bashkisë Durrës, ku edhe pse çdo muaj ndahet me ta kalendari i daljeve në terren, nga ana e tyre nuk është marrë asnjë përgjigje. Policia në asnjë nga daljet në terren nuk ka qenë e pranishme. Në Tiranë ku numri i skuadrave të terrenit është më i madh raportohet që në rastet kur ka qenë e nevojshme prezencë e policisë ka pasur përgjigje në kohë nga Komisaritet.

Nisur nga përvoja dhe bashkëpunimi me policinë gjatë punës në terren, ASHMDF kërkoi nga Drejtoria e Policisë së Shtetit bashkëpunim për organizimin dhe pjesëmarrjen **estrukturave**

të policisë në trajnim për mbrojtjen e fëmijëve. Në datat 19-25 nëntor dy instucionet me mbështetjen e organizatave partnere Terre des Hommes dhe ARSIS, oraganizuan trajnimin mbi “*Rolin dhe përgjegjësitë e punonjësve të policisë në mbrojtjen e fëmijëve dhe puna e grupit multidisiplinar*”. Morën pjesë 115 persona inspektorë, specialistë, SPZ nga komisaritet e Tiranës: Komisaritati Rajonal Policisë Rrugore, Komisaritati i Policisë Kavajë, Komisaritati i Policisë Vorë, Stacioni i Policisë Rrogozhinë, Drejtoria e Përgjithshme e Qarkut Tiranë, Salla operative dhe specialistë të nr 126. Një vend të rëndësishëm në trajnim, pati njohja me procedurat e punës për fëmijët në situatë rruge dhe diskutimi i rasteve konkrete nga puna në terren.

- **Monitormi i zbatimit të PV**

Në zbatim të Planit të Veprimit ASHMDF monitoron dhe koordinon në nivel qendror ecurinë e zbatimit të këtij plani. Bashkitë e përfshira raportojnë çdo tre muaj për zbatimin e Planit të Veprimit. Gjithashtu për çdo muaj dërgohet plani i daljeve në terren dhe databaza e përditësuar e rasteve që menaxhohen nga NJMF. Në muajin nëntor stafi i ASHMDF monitoroi punën në secilën bashki duke evidentuar dokumentacionin në lidhje me :

- Listat e fëmijëve/ database,
- Kalendaret e daljeve në terren.
- Format e vlerësimit dhe vëzhgimit të shpejtë
- Dokumentacioni për grupet multidisiplinaretë mbledhura për fëmijët në situatë rruge.

Në bazë të raportimeve u hartuan shkresa drejtuar bashkive me rekomandimet përkatëse lidhur me ecurinë e punës në këto bashki. Disa nga rekomanimet ishin:

- *Daljet në terren të reduktohen për periudhën nëntor – mars duke u fokusuar në zonat me porpabilitet më të lartë për fëmijë në situatë rruge. dhe nëmenaxhimin e rasteve flagrante të përsëritura të fëmijëve të shfrytëzuar, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore në zbatim të protokollit të mbrojtjes së fëmijëve.*
- *Për rastet kur, me gjithë ndihmën e ofruar mungon bashkëpunimi dhe fëmijët vazhdojnë të shfrytëzohen në rrugë, të ndiqen procedurat ligjore, në bashkëpunim me policinë për personat që shfrytëzojnë fëmijët në rrugë, në zbatim të nenit 124/b të kodit penal.*
- *Të evidentohen dhe plotësohen format e vëzhgimit dhe vlerësimit të shpejtë për çdo rast të identifikuar dhe të firmosen nga 3 personat e skuadrës së terrenit.*
- *Për fëmijët në situatë rruge të regjistruar në shkollë në vitin akademik 2015 - 2016, NJMF të mbledhë informacion çdo 3 muaj nga DAR*
- *Drejtoritë e Shërbimit Social, në bashki të koordinojnë takime periodike tremujore të mekanizmit koordinues në bashki për përplanifikimin e ndërhyrjeve të përbashkëta për fëmijët në situatë rruge dhe hartimi i një plani masash me objektiva konkrete si dhe pikat ku kërkohet mbështetje.*

- **Funksionimi i mekanizmit koordinues për fëmijët në situatë rruge**

Në zbatim të Planit të Veprimit Mekanizmi Koordinues drejtohet drejtoria e Shërbimit Social në bashkitë e përfshira dhe NJMF-të koordinojnë në nivel lokal takimet periodike çdo 3 muaj të këtij mekanizmi. Në këtë mekanizëm ftohen të marrin pjesë drejtues të institucionëve lokale dhe OJF që ofrojnë shërbim për fëmijët në situatë rruge. Në bashkinë Tiranë, ku Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve ishin të sapongritura dhe pa përvojën e mjaftueshme deri në shtator 2015 këto takime i ka koordinuar ASHMDF.

Në bashkitë Fier, Durrës dhe Elbasan, Drejtoritë e Shërbimeve Sociale kanë organizuar në muajin dhjetor takimin e mekanizmit të koordinimit për fëmijët në situatë rruge. Raportohet që aktorët që kanë marrë pjesë në këto takime janë nga DAR, Shëndeti Publik, Policia, Administratorë Rajonalë, Organizata lokale, Grupet e terrenit etj. Në bashkinë Fier janë ftuar dhe kanë marrë pjesë përfaqësues nga prokuroria dhe gjykata. Kurse në bashkinë Durrës edhe pse është kërkuar bashkëpunim me prefekturën Durrës, ka munguar përfaqësuesi nga policia në takim. Veçanërisht në bashkinë Elbasan, mekanizmi i koordinimit funksionon shumë mirë dhe të gjitha rastet e vështira adresohen për zgjidhje dhe pjesëmarrja dhe angazhimi i aktorëve është maksimal.

Në këto takime është diskutuar për punën e bërë deri tani nga skuadrat e terrenit dhe vështirësitë që kanë dalë për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve. Në bashkinë Fier është vlerësuar si pozitive dëshira dhe vullneti i aktorëve për të bashkëpunuar, aksesin e shtuar në shërbime si dhe masat legjislative në mbështetje të familjeve dhe fëmijëve në situatë rruge. Në bashkitë Durrës dhe Fier raportohet që janë diskutuar për sfida që lidhen me ndryshimin e specifikimeve që mbështesin punën e NJMF, pamjaftueshmëria e shërbimeve dhe burimeve financiare për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve në nevojë, mungesa e bashkëpunimit të familjeve, vështirësi në punësimin e familjeve për shkak të mungesës së kualifikimeve profesionale dhe të paragjyqimeve për punësim të personave nga komuniteti rom.

- **Aktivitetet sensibilizuese në kuadër të planit për fëmijët në situatë rruge**

Perioda raportuese nisi me angazhimin e NJMF-ve të bashkive të përfshira në fushatën sensibilizuese në kuadër të muajit antitrafik, ku NJMF koordinuan fushatën me pjesëmarrjen e vullnetarëve dhe të aktoreve të tjerë nga bashki. Në secilën bashki, Durrës, Fier, Vlorë u ndanë nga 3000 fletë ndërgjegjësuese. Në katër bashkitë u ngritën info points ku qëndronin njëj-te dhe vullnetarët për informimin dhe ndarjen e fletëpalosjeve për qytetarët kundër fenomenit të shfrytëzimit të fëmijëve në situatë rruge. Motoja e fushatës ishte “Asnje fëmijë në rrugë për punë dhe lypje”

Fushata ka vijuar përgjatë gjithë muajit tetor, ku janë organizuar NJMF-të aktivitetet ndërgjegjësuese në komunitete, shkolla, qendra komunitare, institucione.

Me rastin e festave të fundvitit u organizuan festa me dhurata me fëmijët në situatë rruge, të organizuara nga ASHMDF me pjesëmarrjen e Ministrisë së MMSR, Z Blendi Klosi. Njëri aktivitet

u zhvillua në shkollën 9 vjeçare “Pal Engjëlli”, shkollë qëpret shumë prej fëmijëve që vijnë nga një situatë rruge dhe të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Aktiviteti tjetër festiv “Festat duan Dashuri” u zhvilluan në qendren Rinore, me pjesëmarrjen e 150 fëmijëve në situatë rruge që janë menaxhuar nga 11 NJMF-të e bashkisë Tiranë. Fëmijët dhe prindërit e ftuar treguan historitë e tyre të suksesit dhe mënyrën si janë mbështetur për tu riintegruar.

Të dhëna në total qershor 2014 - dhjetor 2015

Bashkia	Nr i sk. terrenit	Raste të identifikuar	Raste të menaxhuar	Raste të referuar për regjistrim në shkollë		Raste referuar për kopsht		Raste referuar për çerdhe		Rastetndermjetesuar per punesim		Raste për ndjekje penale
				referuar	regjistruar	referuar	regjistruar	referuar	regjistruar	referuar	punesuar	
Durrës	3	81	32	9	7		1					
Elbasan	4	39	31	11	8	3	3			5	1	1
Fier	3	19	11	32	13					3		
Tiranë	11	371	169	232	63	38	14	47	11	143	77	17
Total	21	510	243	284	91	41	18	47	11	141	78	18

Të dhënat tremujore tetor – dhjetor 2015

Bashkia	Nr I sk. terrenit	Raste reja të identifikuar	Raste të menaxhuar	referuar regjistruar në shkollë	referuar regjistruar për kopsht	Raste referuar për çerdhe	Rastetndermjetesuar per punesim		Raste për ndjekjepenale
							referuar	punesuar	
Durrës	1	13	10	-	-	-	-	-	-
Elbasan	3	0	16	-	-	-	5	-	-
Fier	2	2	5	-	-	-	3	-	-
Tiranë	11	10	4	21	14	-	71	35	-
Total	17	25	35	21	18	-	79	78	-